




Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës  
Opština Priština - Municipality of Prishtina



**KRYETARI I KOMUNËS**

Në bazë të dispozitave të nenit 13 dhe 58, shkronja f) të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", me 28/04, qershor 2008), dispozitave të nenit 52, shkronja f) dhe nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391, të dt. 25.02.2010, dhe kërkesës së Arbërie Nagavci, drejtoreshë e Drejtorisë së Arsimit, për dorëheqjen e saj, Kryetari i Komunës së Prishtinës merr këtë

**V E N D I M**

**Për shkarkimin e drejtorit të Drejtorisë së Arsimit**

- I. Arbërie Nagavci, shkarkohet nga pozita e drejtorit të Drejtorisë së Arsimit të Komunës së Prishtinës.
- II. Lirimi nga posti i cekur në pikën I të këtij vendimi bëhet me kërkesën e saj, pasi e njëjta sipas Rezultateve përfundimtare të KQZ-së ka fituar mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, në zgjedhjet e parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës të mbajtura në qershor të 2017.
- III. Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit të tij.

**I DORËZOHET:**

- Të shkarkuarës;
- Drejtorisë së Financave;
- Njësisë së Personelit;
- Qendrës për shërbime me qytetar;
- Në dosje.



14.08.2017